

Kopje e vërtetë me origjinalin  
Dr. A. Tullhanetaj  
Sek. Përgj. A. Bylykbashi

32

## FORMULARI I KONTRATËS

Titulli i Kontratës: “Rehabilitimi urban i sheshit “Zaranika” dhe Bulevardi “Aqif Pasha” (segmenti nga Kryqezimi 1 Maji- Ura e Zaranikes) -Faza IV”.

Kjo Kontratë është lidhur më date 28. 08.2017, midis Bashkise Elbasan tani e tutje të referuar si “Autoriteti Kontraktor” dhe bashkimit te operatoreve ekonomik: “Be-Is” sh.p.k., & “Aurora konstruksion” sh.p.k, sipas kontrates së bashkepunimit te shoqerive date 19.05.2017 dhe Prokures se Posaçme Nr.2568 Rep. 1180 kol. date 19.05.2017 te Dhomes se Notereve Tiranë, i percaktuar me poshte si “Kontraktuesi”.

Menjëherë pasi Autoriteti Kontraktor paraqet një kërkesë për Realizimin e Punëve, duke i'u referuar prokurimit nr. \_\_\_\_\_

Menjëherë pasi Kontraktori, me anë të ofertës së tij, me datë 22.05.2017 bie dakord të realizojë Punët, ashtu siç janë të specifikuara në kushtet e përcaktuara në:

- Këtë Formular Kontrate
- Formularin për Ofertë, të paraqitur nga Ofertuesi
- Përshkrimin e Kërkesës për Kualifikim
- Programin Përfundimtar dhe Specifikimet Teknike
- Preventivin e Kostove
- Kushtet e Përgjithshme të Kontratës
- Kushtet e Veçanta të Kontratës
- Njoftimin e Fituesit nga Autoriteti Kontraktor
- Formularin e Sigurimit të Kontratës

Të gjitha këto dokumenta të bashkangjitura përbëjnë pjesë integrale të kësaj Kontrate. Menjëherë pasi Autoriteti Kontraktor pranon Ofertën nga Kontraktori në një shumë prej **118,504,489** (njëqind e tetëmbëdhjetë milion e pesëqind e katërmijë e katërqind e tetëdhjetë e nëntë) lekë (me tvsh), për realizimin e Punëve:

Palët bien dakort si më poshtë:

1. Kontraktuesi duhet të paraqesë një Sigurim Kontrate në shumën prej: **11.850.448,9** (njembedhjetemilion e teteqind e pesedhjetemije e katerqind e dyzet e tete presje nente) **lekë**, dhe ne formën e Depozites Bankare/ Certifikates se Garancise, në ose përpara datës së shprehur në Njoftimin e Fituesit.
2. Kontraktuesi është i detyruar të kryejë Punët për Autoritetin Kontraktor, siç kërkohet në këtë Kontratë.
3. Autoriteti Kontraktor është i detyruar të paguajë për Punët, në shumën e parashikuar në këtë Kontratë.
4. Në këtë Formular Kontrate, fjalët dhe shprehjet do të kenë të njëjtin kuptim që i ngarkohet atyre në Kushtet e Kontratës.
5. Palët e kësaj Kontrate kanë përgjegjësi për moszbatim ose zbatim të papërshtatshëm të detyrimeve të tyre kontraktore dhe për dëmet e shkaktuara secilës nga moszbatimi i detyrimeve, që janë subjekt kompensimi, në përputhje me Kushtet e Kontratës.





